

Tradhëtarët e Kombit

Ylli Përmeti

Historia njerëzore është e mbushur plot me tradhëtarë. Por asnjë herë shoqëritë s'kanë përcaktuar se cilët kalojnë në këtë spektër degradues. Dhe kjo sepse, shoqëritë janë në ndryshim modelesh të vazhdueshme. Këto modele apo stereotipe i bëjnë shoqëritë të gjenerojnë në pafundësi tradhëtarë. Si rrjedhojë, shoqëritë njerëzore do të gjenerojnë gjatë gjithë kohës tradhëtarë. Dhe pikërisht, tradhëtarët gjenerojnë këtë sens tradhëtie, sepse, u mungon sensi i kundërt: Humanizmi. Por ç'është të jesh tradhëtar?

Tradhëtar është ai/ajo që tradhëton një vlerë të dhënë, e cila ka lidhje të ngushtë me vetë-identitetin e një personi, njësie apo shoqërie. Tradhëtar është gjithashtu ai/ajo që tradhëton një marrë-dhënie, punë, vepër apo krijim individual, shoqëror apo kombi – herë pas here ky i fundit quhet sabotazh. Për më shumë, tradhëtar është ai/ajo që shesin vendin e vetë për interes të ngushtë personal. Ky lloj tradhëtari, është tradhëtari më i keq.

Sidoqoftë, dikush mund të kundërshtoi antonimin e tradhëtarit, cituar pak më lart: Humanizmin. Dhe në vend të tij, mund të vendos, patriotizmin ose nacionalizmin. Por, këta të fundit, kanë lidhje të ngushtë më shumë me vlerat, etnometodologjitë dhe historinë e një kombi. Ndërsa, humanizmi është koncept pak më i gjerë, më universal dhe më natyral. Është i tillë sepse, humanizmi nuk mund të kundërshtohet me kundër-vlerë apo kundër-metodologji (përveç qënieve jashtë-tokësore); ndërkohë, gjithë të tjerët, kundërshtohen lehtë. Ky është thelbi i tradhëtisë: Tradhëtia hyn në atë fushë ku demonstrohen më shumë se asgjë tjetër vlerat dhe etnometodologjitë e një kombi tjetër, të cilat stigmatizojnë vlerat homogjene. Në fjalë

të tjera: Tradhëtia është më shumë anti-humane sesa anti-etnometodologjike.

Kështu, sipas korolarit të mësipërm, cilët janë tradhëtarë kundër kombin tonë dhe cilët janë anti-humanistë? Që në fakt, i pari është më i dëmshëm se i dyti, dhe anasjelltas. Dhe tradhëtari e fillon "desertimin" e tij nga vlerat e një kombi; nga pasuria e tij më e shtrenjtë dhe arrin spontanisht në anti-humanizëm. Ky lloj tradhëtari kurohet në se shoqëria themelon burgje tradhëtarësh, por, cila rrugë është më e mirë për një komb: T'a ekzekutoj këtë lloj tradhëtari apo t'a kuroi? Natyrisht, kjo varet nga lloji' tradhëtisë që dikush ka kryer. Në se tradhëtia kalon cakun shoqëror dhe demonstron me dëme kombëtare dhe humbje humane, tradhëtari nuk meriton të kurohet; në anën tjetër, në se tradhëtia demonstron vetëm me lëndim shpirtëror, atëherë, ndoshta tradhëtari meriton të kurohet. Por, a kanë themeluar shoqëritë civile ambiente rehabilitimi për tradhëtarët? Kurrsesi, jo! Kjo për arsye se shoqëritë janë shumë të varfra intelektualisht për të përcaktuar se cilët janë tradhëtarë. Për këtë arsye, në këtë tekst do t'rradhësim disa lloj tradhëtarësh, dhe në se dikush gjen veten e vetë në këto rradhë, atëherë, s'ka rrugë tjetër, veçse, të kuroj vetë-veten duke kundruar rreth tradhëtisë së tij/saj ose të shpall tradhëtinë në publik me qëllim që të ndëshkohet. Kjo e fundit është pothuajse e pamundur.

E megjithatë, tradhëtarë janë të gjithë ata që:

- 1. Fillojnë duke abuzuar me vlerat e një shoqërie dhe në vend të tyre kërkojnë të adoptojnë vlera të një shoqërie tjetër. Në këtë sektor mund të përmendim: Emrat, sjelljen, veshjen etj;*
- 2. Kalojnë në krijimin e institucioneve që kanë si gjenezë një vend tjetër. Në këtë sektor mund të përfshijmë: Pushtetet (fetë, partitë), medien dhe institucionet shoqërore; dhe*
- 3. Krijojnë kushte për shoqëritë e huaja që të ekspansionojnë vlerat, institucionet dhe shoqëritë e tyre, madje, edhe gjuhën e tyre, si në rastin e gjuhës Angleze e cila tenton të zëvendësoi gjuhën amëtarë të një kombi; ose në rastin e feve, të cilat meshën e tyre, e mbajnë në bazë të gjuhëve ku fetë kanë lindur dhe adoptojnë veshje dhe sjellje karakteristike të*

feve përkatëse duke shpërfillur prakticitetin e tyre dhe duke përfillur vetëm gjenezën e tyre.

Kështu, sipas gjykimit të mësipërm, cilët janë tradhëtarë në vendin tonë? Cilët kopjojnë me naivitetin më të madh vlerat, emrat, kulturën, institucionet, pushtetet dhe më të keqen e mundshme, i sjellin këto shoqëri në vendin e tyre për *fitim* personal, duke shpërfillur atë shoqëror, kulturor dhe kombëtar! Edhe një herë: Ç'është tradhëtari? A mund të jetë tradhëtari një njeri që di paraprakisht rëndësinë e vlerave shoqërore dhe kombëtare? Kurrësesi jo! Në se dinte rëndësinë e tyre, ai/ajo nuk do të ishin tradhëtar. Atëherë, ç'e shtyn tradhëtarin që të bëj diçka të tillë? Natyrisht, në njërin anë, është injoranca e tij/saj, në anën tjetër, është mos realizimi i kësaj qënieje të realizoi unin e vetë në hapësirën ku koniuktura e ngjizjes e çoi të natyralizohet. Kjo e fundit është më shumë e mundur sepse e çon individin në "zemërim" kundrejtë mos-realizimit të unit por edhe e para është pjesë e këtij planktoni. Ndërkohë, planktoni është ushqimi' florës së botës së peshqve; pa të peshq nuk do të kishte, në anën tjetër: Cili është ushqimi i politikanëve tanë? – kur ata unin e tyre e kanë realizuar; ky realizim është pjesë e demonstrimit të politikës së tyre.

Ndërkohë, gjithkush mund të mendoj në këtë pikë se është injoranca, por mund të shtojmë edhe një element tjetër: Pangopësinë. Këtë arsyetim e bëj nën justifikimin se nuk mund të pranoj se politikanin është injorant; për shumë arsye. Por edhe në se e pranoj, ç'e shtyn politikanin, që të demonstroi politikë? Edhe në këtë kontekst, del se shtyhet nga pangopësia. Kjo sepse politikanin demonstroi pangopësi dhe jo përkore. Atëherë, a ka mundësi që pangopësia të gjeneroi zgjuarsin? Ose, a ka mundësi pangopësia të gjeneroi injorancë? Duket se verianti' dytë është më mundshëm se sa i pari. Por ajo që është më rëndësishme, është se kur një politikan demonstroi pangopësi, atëherë, kjo dukuri do të përsëritet ekzaktësisht sikurse valët zanore: Përmes planktonit atmosferik. Kur një shoqëri arrin në këtë stad zhvillimi, atëherë kjo shoqëri ka rritur stadin e "kushërinjëve" të tyre: Kafshës! Por a mund të arrij një shoqëri një stad tjetër zhvillimi? Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, n'a duhet të pranojmë se politikanët nuk udhëhiqen nga pangopësia dhe njëkohësisht politikanët duhet të

demonstrojnë përkore. Natyrshëm lind pyetja tjetër: Ç'është politikani? Natyrisht që politikani është njeri dhe si njeri ai/ajo gabon. Atëherë, kur nuk mund të gaboj një njeri. Ose, kur ka mundësi një njeri që t'mos gaboi? Natyrisht, atëherë kur ka përball kundër-pushtet më racional. Sa racional atëherë, është pushteti ynë kur këta pushtete adoptojnë vlerën e pangopësisë? Mos ndoshta, europa e shumë kërkuar demonstroi përkore dhe ne gabojmë? Natyrisht, e njëjta forcë udhëheq edhe europën. Atëherë, ç'ne që ne e kërkojmë kaq shumë europën: Mos ndoshta n'a krakterizon të gjithëve pangopësia dhe rrjedhimisht tradhëtia? Ky argument, nuk mund të pranohet: Sepse nëse e pranojmë, atëherë ne jemi kafshë...!

Si përfundim, dalim tek e njëjta pyetje: Cilët janë tradhëtarët e kombit?

Tradhëtarët e parë të një kombi homogjen janë politikanët; kjo sepse ata janë promotorët e vetëm të vlerave të huaja; ata shesin dhe blejnë për interes personal pasurinë e kombit; të atij kombi që është homogjen kundrejtë atij heterogjen. Kombe të tillë janë vendet perëndimore, sikurse, Franca, Anglia, Amerika etj, ku edhe këta dikur kanë qënë homogjen. Ndërkohë, tradhëtarët e dytë janë të gjithë të tjerët që pranojnë tradhëtinë e të parëve sikur të ishte një llokum i ëmbël që në fakt përmban helm. Këta janë tradhëtarët e kombit, dhe veçanërisht të atij Shqiptar!

20 Shtator 2010